



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Pro & Co Group ShPK" të datës 31.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Pro & Co Group ShPK" të datës 31.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Pro & Co Group ShPK" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 31.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**Pretendimi nr. 1** – “Kërkesat për Certifikimet e Stafit në Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Këto kërkesa janë të natyrës diskriminuese, pasi që vendosin standarde të shumta dhe të paqarta, duke krijuar një barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë”.

Lidhur me këtë pretendim duhet sqaruar se të gjitha kërkesat e DT sa i përket standardeve të cilësisë dhe/apo certifikimet tjera përkatëse, janë hartuar me kujdes duke marrë parasysh kompleksitetin dhe natyrën e projektit. Në rastin konkret kërkesat për stafin e operatorit ekonomik tenderues janë të gjitha kërkesa apsolutisht të domosdoshme. Mospërmbushja e secilës prej tyre do të rrezikonte në mënyrë thelbësore jo vetëm cilësinë dhe nivelin profesional të projektit në fazën e implementimit, por edhe efikasitetin dhe efektivitetin e realizimit të projektit si të tillë. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

**Pretendimi nr. 2** – “Afati i Shkurtër për Përgatitjen dhe Dorëzimin e Ofertave. Afati prej 15.08.2024 deri më 06.09.2024 për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave është tejet i shkurtër”.

Lidhur me këtë pretendim duhet sqaruar se për këtë aktivitet të prokurimit është publikuar njoftimi paraprak për kontratë. Megjithatë sipas nenit 44 dhe 45 të LPP përcaktohet se afati për dorëzimin e ofertave në aktivitetet e prokurimit për të cilat është publikuar njoftimi paraprak për kontratë, duhet të jetë së paku 24 ditë. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar në pikën ku thuhet se afati për dorëzim të ofertave nuk mund të jetë më pak se 24 ditë. Rrjedhimisht AK duhet të publikoj formularin për korrigjimin e gabimeve njoftimet e publikuara përmes të cilit do të bëj zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit.

**Pretendimi nr. 3** – “Kërkesat për Pajisje të Rënda. Në dosjen e tenderit janë përfshirë kërkesa për pajisje me peshë të rëndë, duke përfshirë: •Eskavator për gërmim mbi 45 ton; •Eskavator me krah të gjatë min. 22 metra; •Autobot për pastrimin e kanaleve dhe pusetave me vëllim min. 20,000 litra; •Gjysemrormorkio për bartjen e automjeteve me peshë minimale të ngarkesës së lejuar 50 ton. Këto kërkesa për pajisje janë diskriminuese dhe reduktojnë ndjeshëm mundësitë e pjesëmarrjes në tender”.

Sa i përket kërkesës për eskavator me krahë të gjatë min. 22 metra, AK ka analizuar me kujdes projektin dhe paramasën e projektit me ç’rast ka konstatuar se për realizimin me sukses të projektit mjafton që eskavatori të jetë me krahë të gjatë min. 18 metra. Ndërsa pajisjet tjera duhet të mbesin të pandryshuara. Ato janë hartuar me kujdes duke marrë parasysh kompleksitetin dhe natyrën e projektit. Në rastin konkret kërkesat për pajisje janë apsolutisht të domosdoshme. Mospërmbushja e secilës prej tyre do të rrezikonte në mënyrë thelbësore jo vetëm cilësinë dhe nivelin profesional të projektit në fazën e implementimit, por edhe efikasitetin dhe efektivitetin e realizimit të projektit si të tillë. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar vetëm pjesërisht.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar vetëm pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 04.09.2024**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.